

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGENCIA KOSOVITE SPOVETELITET - KOSOVA AGENCIA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Br. No. VI
5080 / 2026 - 1N
Nr i Fa. Br. Str. No. Pg. 5
Data Datum Date 08.01.2026
Prishtinë / Pristina

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA - SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-23-0472	Data: Datum: Date:	19.12.2025
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:
Aktvendim			12.12.2025

Pala	Stranka	Party	
Pranuar nga	Primio:	Received by	
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrimi	Potpis:	Signature	





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:211144

Datë: 17.12.2025

Numri i dokumentit: 08224812

C-IV-23-0472

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit; NSH KB Fryti në Lipjan në likuidim, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55 Lakërishtë, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Ferki Xhaferi me datën; 12.12.2025, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit të NSH KB Fryti në Lipjan.
2. Lejohet mbyllja e rastit të likuidimit ndaj NSH KB Fryti në Lipjan.
3. Lirohet Autoriteti i Likuidimit nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit ndaj NSH KB Fryti në Lipjan.
4. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datën 03.10.2023, pranë Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS), parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar Raportin Përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH KB Fryti në Lipjan. (tani e tutje subjekti raportues), pasi që ka ardhur në përfundim që NSH KB Fryti në Lipjan, nuk ka asete te realizueshme, dhe duke pas parasysh faktin se janë përmbushur te gjitha kërkesat kreditore, te vlefshme ne pajtim me nenin 40 te ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, dhe vërtetimit se nuk ka asete te regjistruara ne DHPGJS, gjykatës i kishte kërkuar qe aprovoi kërkesën.

Autoriteti i Likuidimit tutje thekson se gjatë procedurës së likuidimit nuk ka të parashtruara asnjë kërkesë kreditore ndaj NSH-së, subjekt i këtij raporti përfundimtar.



Andaj Autoriteti i Likuidimit i propozoj gjykatës që në pajtim me nenin 43 dhe 44 paragrafi 3 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së) pas shqyrtimit të kërkesës të aprovojë Raportin Përfundimtar dhe të merr vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje si dhe Autoriteti i Likuidimit të lirohet nga çfarëdo detyre të mëtejme lidhur me subjektin e këtij raporti përfundimtar.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, pas shqyrtimit të kërkesës, konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore sipas kërkesës së Autoritetit të Likuidimit.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, i parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

Paragrafi 2 i nenit 43 përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3 i shtojcës së Ligjit bazik po ashtu i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar Raportin Përfundimtar për aprovim përfshirë dëshmitë në vijim që janë shqyrtuar nga gjykata.

Me datën 31.10.2013 Bordi i Drejtorëve të AKP-se ka nxjerr vendim për likuidimin e NSH-së ndërsa me datën 22.11.2013 ka emëruar anëtarët e Autoritetit të Likuidimit për subjektin e këtij raporti. Për më tepër, në shkresa të lëndës të bashkangjitura me kërkesë (shtojca 1 dhe 2 e Raportit).

Me 08.12.2013 Autoriteti i Likuidimit ka publikuar njoftimet për fillimin e procesit të likuidimit, njoftime këto të publikuara në shtypin ditor si Zëri, dhe Danas. Për më tepër, në shkresa të lëndës të bashkangjitura me kërkesë (shtojca 3 e Raportit).

Me datën 02.12.2013 Autoriteti i Likuidimit ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj NSH-je tek institucionet relevante :



- DHPGJS,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Drejtoria për gjeodezi dhe kadastër Lipjan;
- ATK;
- Gjykata Themelore Prishtinë;
- Gjykata Themelore Prishtinë – Dega ne Gllogovc;
- Gjykata Themelore Prishtinë – Dega ne Graqanicë;
- Gjykata Themelore Prishtinë – Dega ne Lipjan;
- Gjykata Themelore Prishtinë – Dega ne Podujevë;
- Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti ekonomik;
- Gjykata e Apelit Prishtinë;
- Gjykata Supreme e Kosovës;
- Procredit Bank;
- RBKO;
- Banka për Biznes;
- NLB dhe,
- TEB;

Për më tepër, në shkresa të lëndës të bashkangjitura me kërkesë (shtojca 2 e Raportit).

Nga shkresat e cekura si më lartë është shënuar edhe regjistri i aseteve të shitura si dhe regjistri i pronave të hequra dorë. Për më tepër, në shkresa të lëndës janë të bashkangjitura me kërkesë (shtojca 9 e Raportit).

Kërkesës po ashtu i është bashkangjitur edhe një kopje e listës së aseteve të subjektit raportues.

Në këtë pjesë janë të bashkangjitura në mënyrë të detajuar, shkresat si në vijim:

- Nga shtojca me numër rendor 1 deri në shtojcën me numër rendor 16 si dhe nga shtojca që fillon me shkronjën A deri në shtojcën me shkronjën H.

Nga të cekurat si më lartë, gjykata konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit përkatësisht Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe vendimet e nevojshme për mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je, në pajtim me ligjin, andaj aprovon Raportin Përfundimtar të NSH-së dhe lejon mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je.

Me këtë aktvendim ndërpritet ekzistimi i kësaj ndërmarrje dhe rasti mbyllet.

Autoriteti i Likuidimit i mbetet në përgjegjësi për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, të parapara sipas nenit 46.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nga gjitha arsyet e sipërpërmenduar u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.



Numri i lëndës: 2023:211144
Datë: 17.12.2025
Numri i dokumentit: 08224812

Shpenzimet gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen shpenzimet tjera procedurale.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi.

DHOMA E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

2023:211144, 12.12.2025

Gjyqtari
Ferki Xhaferi

